



Bachelor i Ri

në “Financë dhe Kontabilitet”

“Pas çdo vendimmarrjeje të zgjuar, qëndrojnë njohuritë financiare”

Pse ky program studimi?

- Program bashkëkohor, i zhvilluar në bashkëpunim me Universitetin BOKU dhe i përshtatur me kërkesat dinamike të tregut të punës
- Ndërthur njohuritë teorike me aplikime praktike në financë dhe kontabilitet
- Zhvillon aftësi në analizë, menaxhim dhe vendimmarrje financiare
- Siguron formim në vlerësimin dhe analizën ekonomike e financiare, si dhe në hartimin e politikave dhe projekteve zhvillimore
- Pajis studentët me aftësi për analizën e burimeve dhe mënyrave të financimit
- Ofron njohuri mbi funksionimin e tregjeve dhe institucioneve financiare
- Zhvillon kompetenca për raportim financiar sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të kontabilitetit
- Integron teknologjitë moderne dhe konceptet FinTech, që po transformojnë shërbimet financiare globalisht dhe në Shqipëri.
- Rrit punësimin dhe përshtatshmërinë në një mjedis dinamik profesional

Kompetencat kryesore të fituara

Studentët e diplomuar në këtë program do të fitojnë:

- Njohuri të thelluara profesionale dhe aftësi analitike në fushën e financës dhe kontabilitetit, për njësitë ekonomike të sektorit bujqësor dhe të sektorëve të tjerë ekonomikë
- Aftësi mbi përdorimin e qasjeve bashkëkohore, përfshirë teknika, metoda, software, të analizës së shëndetit financiar të njësive ekonomike të dobishme në marrjen e vendimeve financiare.

- Njohuri për të vlerësuar dhe adresuar riskun financiar të aktivitetit ekonomik dhe të financimit të njësive ekonomike
- Aftësi mbi metodat e raportimi financiar dhe të zbatimit të standardeve të kontabilitetit, për sektorit privat dhe publik;
- Kapacitete për planifikimin financiar, buxhetimin dhe zbatimin e projekteve të investimeve në fushën e bujqësisë dhe agrobiznesit, si edhe njohuri mbi skemat e financimit dhe efektivitetit e tyre në sektorin e bujqësisë, por jo vetëm.
- Aftësi për të hartuar dhe propozuar politika ekonomike dhe projekte që nxisin zhvillimin dhe përafrimin me politikat e integritit në Bashkimin Europian.

Aftësi për të vlerësuar ndikimin financiar, ekonomik dhe social të programeve, apo politikave të ndryshme publike dhe private mbi njësitë ekonomike.

Mundësi punësimi

Të diplomuarit mund të ndjekin karrierën në pozicionet e rolet e mëposhtme si:

- Në institucionet dhe organizatat financiare, në institucionet financiare dhe bankare, si edhe në ato jo bankare. Në role të tilla si menaxher financiar, analist financiar, analist krediti, ekspert shërbimesh financiare për individë, biznese dhe qeverinë.
- Në sektorin privat, në njësitë ekonomike private dhe OJF-të si specialist finance, kontabiliteti dhe buxheti, si dhe në rolin e këshilluesit financiar etj.
- Në sektorin publik, në institucionet publike në nivel qendror dhe lokal si specialist buxheti, ekspert i sistemit fiskal, specialist borxhi, specialist për financat lokale etj.
- Në institucionet e arsimit të lartë, të arsimit publik dhe privat, si edhe në institucionet e kërkimit shkencor, publike dhe privat si specialist finance dhe buxheti, analist investimesh, asistent kërkimi etj.
- Në tregun jo financiar, në tregun e sigurimeve dhe tregun e pasurive të paluajtshme si agjent shitjesh, financier, këshillues etj.

Në institucione dhe organizata ndërkombëtare si konsulent financiar për politika dhe projekte zhvillimore, specialist finance dhe kontabiliteti, specialist për vlerësimin dhe monitorimin e projekteve.

Alumni dhe Eksperienca

Florinda Zherri

Asistent professor, Departamenti Financë Kontabilitet, Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit Universiteti Bujqësor i Tiranës

“Ky program më frymëzoi të vazhdoj rrugën akademike dhe sot, si asistent profesor, ndaj të njëjtat vlera dhe njohuri me studentët e mi”

Henri Ndreca

Drejtor i Përgjithshëm i T-Blocks

“Studimet në Financë-Kontabilitet ndërtuan themelin e lidershit tim, duke më pajisur me mendim strategjik, disiplinë analitike dhe vizion për inovacion. Sot, si Drejtor i Përgjithshëm i T-Blocks, këto kompetenca përkthehen në vendimmarrje të qëndrueshme dhe zhvillim të vazhdueshëm të biznesit”

Fatmir Nikolli

Drejtor Rajonal dhe Drejtor i Segmentit të Bujqësisë (NOA, SHA)

“Studimet në Financë-Kontabilitet më dhanë bazën për të udhëhequr me vizion dhe për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit bujqësor në nivel rajonal”

Esmeralda Doçi

Përgjegjëse Sektorit të Kontabilitetit të Përgjithshëm, Drejtorja e Financës, Instituti i Sigurimeve Shoqërore

“Studimet në Financë-Kontabilitet më ndërtuan bazën e fortë profesionale dhe integritetin e nevojshëm për të menaxhuar me përgjegjësi financat publike dhe për të garantuar transparencë në administrim”

Si zbatohet ndërdisiplinarteti i programit?

- 50 % kredite në Shkencat Sociale
- 24-25 kredite në shkencat natyrore
- 24-25 % kredite në shkencat teknike

Për ndërtimin e këtij programi është ndjekur parimi i ndërdisiplinartetit, i cili synon integrimin e qasjeve, metodave, teknikave dhe mjeteve analitike të disiplinave të ndryshme, duke prodhuar njohuri të reja dhe zgjidhje të problemeve komplekse e me ndikim real për sfidat ekonomike, financiare, sociale e teknologjike të një bote në ndryshim të shpejtë dhe të vazhdueshëm. Kjo qasje ndërdisiplinore, e cila pasqyron realitetin e ndërlidhur të botës moderne të biznesit dhe ndjek shembullin e programeve të suksesshme ndërkombëtare, u jep studentëve një perspektivë më të gjerë dhe aftësinë për të analizuar dhe zgjidhur probleme komplekse nga këndvështrime të shumëfishta. Në përputhje me standardet ndërkombëtare (Muster Curricula), programi integron

njohuri nga fushat e teknologjisë, shkencave natyrore dhe ekonomisë dhe siguron një formim gjithëpërfshirës që përgatit studentët për sfida komplekse.

Cilat programe Master mund të ndiqen?

- Financë
- Kontabilitet
- Financë dhe Kontabilitet
- Kontabilitet dhe Auditim
- Financë dhe Bankë
- Administrim Biznesi
- FinTech
- Ekonomi
- Politika Publike
- Menaxhim Financiar Publik